



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 4667/1 prot.

Tiranë, më 28.09.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1049/1, datë 31.07.2007.

SHOQËRISË "ALLBENIA-FERRO" SH.P.K

Rr. "Sheshi Italia", Tirana Sheraton Hotel & Towers , Kati 1 Shopping Mall, Tiranë

Për dijeni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Blloku "Vasil Shanto", Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë

Shoqëria "ALLBENIA-FERRO" sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1049/1, datë 31.07.2007, për mineralin kuarc, në Objektin "Kodra e Nocit, Kallabak, Shishtavec", Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 2629 prot., datë 30.06.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 4661 Prot., datë 01.07.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1049/1, datë 31.07.2007, për mineralin kuarc, në Objektin "Kodra e Nocit, Kallabak, Shishtavec", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, pasi në objekt nuk zhvillohet aktivitet minerar prej më shumë se një viti kalendarik.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma "c" të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1049/1, datë 31.07.2007, për mineralin kuarc, në Objektin "Kodra e Nocit, Kallabak, Shishtavec", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1049/1, datë 31.07.2007, për mineralin kuarc, në Objektin "Kodra e Nocit,

Kallabak, Shishtavec”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

AMI KOZELI

